



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Kryesia e Kuvendit  
P-022

Prishtinë, më 10 qershor 2008, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE  
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 10 QERSHOR 2008**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Slllobodan Petroviq dhe Xhezair Murati, kurse mungoi Nexhat Daci;

Nga grupet parlamentare: Lutfi Haziri, Ardian Gjini, Lulzim Zeneli dhe Zylfi Merxha, kurse munguan: Ramë Buja, Ibrahim Makolli dhe Bojan Stojanoviq;

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Skënder Reçica dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit : Eshref Vishi;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe fillimisht i njoftoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare se rendi i ditës dhe materialet për këtë mbledhje janë shpërndarë me kohë.

Ndërkohë kanë arritur edhe disa kërkesa për plotësimin e rendit, siç janë:

1. Kërkesa e Presidentit dhe e Kryeministrit për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme lidhur me miratimin e Himnit të Republikës së Kosovës;
2. Kërkesa e deputetit Mahir Jagçilar lidhur me formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Parlamentin e Kosovës dhe atij të Turqisë;
3. Njoftimi i Ambasadës Amerikane lidhur me vizitën e Delegacionit të Kongresit Amerikan, në krye me zotin Eliot Engël, në përbërje prej 15 anëtarëve, dhe
4. Të ndryshme- dhurimi i kompjuterëve të përdorur.

Kryesia miratoi rendin e ditës me propozimet shtesë.

Në vazhdim, Kryetari procedoi sipas rendit të ditës.

### **1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 qershor 2008**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 3 qershor 2008, u miratua pa vërejtje.

### **2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës**

**Kryetari** i njoftoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për shqyrtim në seancën e radhës dhe kërkoi pëlqimin e tyre për secilën pikë, veç e veç.

**Kryesia**, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme me propozimin e kryetarit, vendosi që seanca plenare të mbahet më 19 qershor 2008, duke filluar në orën 10:00, me këtë

### **R e n d i t e:**

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 2 e 3, 4, 5 dhe 11 qershor 2008,
2. Koha për pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armët,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-43 për akreditimin,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për administratën tatimore dhe procedurat,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë,
7. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për ridestinimin e mjeteve për investimet kapitale nga Projekti: “Kompleksi i ri qeveritar” për Projektin: “Rinovimi i Pallatit të mediave”.

### **3. Shqyrtimi i kërkesës së Presidentit dhe të Kryeministrit për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme për miratimin e Himnit të Republikës së Kosovës**

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamente se Komisioni për përzgjedhjen e simboleve, i mandatuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, ka përfunduar punën lidhur me përzgjedhjen e Himnit të Republikës së Kosovës, andaj Presidenti dhe Kryeministri kanë kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që ta thërrasin seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit për ta miratuar Himnin shtetëror të Republikës së Kosovës.

**Kryesia**, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet më 11 qershor 2008, duke filluar në orën 11:00, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Himnit shtetëror të Republikës së Kosovës.

### **4. Njoftimi i Ambasadës Amerikane lidhur me vizitën e Delegacionit të Kongresit Amerikan, në krye me zotin Eliot Engël**

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamente me shkresën e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, me të cilën ishte njoftuar se një delegacion i Kongresit Amerikan në përbërje prej 15 vetash, i kryesuar nga kongresisti Eliot Engël, do ta vizitojë Kosovën, i cili kishte shprehur dëshirën që, përveç tjerash, me një fjalë rasti t’iu drejtohet deputetëve të Kuvendit.

**Kryesia**, pasi diskutoi lidhur me vizitën e delegacionit të Kongresit Amerikan në Kosovë, vendosi që ta thërras një seancë solemne, më 16 qershor 2008, duke filluar në orën 11:00, me këtë

R e n d d i t e:

1. Fjala e rastit e zotit Eliot Engel, anëtar i Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, drejtuar deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### **3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave**

3.1 Shqyrtimi i Mocionit të deputetit Driton Tali, mbështetur edhe nga pesë deputetë të Kuvendit, për nxjerrjen e një deklarate lidhur me formimin (eventual) të strukturave paralele komunale serbe në Kosovë, në bazë të zgjedhjeve të 11 majit,

Kryesia, pasi shqyrtoi mocionin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohe nga propozuesi që mocionit t’ia bashkëngjese tekstin e Projekt-deklaratës për t’i plotësuar kushtet procedurale, në bazë të së cilave Kryesia e Kuvendit mund ta radhisë në rend dite të seancën plenare brenda tri javësh pune.

### **3.2 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion lidhur me tërheqjen e Ligjit për miniera e minerale, të Ligjit për hulumtime gjeologjike, si dhe miratimin e vërejtjeve në Ligjin për ngrohje qendrore**

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e këtij komisioni, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

1. Mbështetet Rekomandimi i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, transport e Telekomunikacion për tërheqjen e Ligjit për miniera e minerale, të Ligjit për hulumtime gjeologjike, si dhe të Ligjit për ngrohjen qendrore.
2. Të informohet Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës lidhur me Rekomandimin e cekur në paragrafin një (1) të këtij përfundimi.

### **3.3 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa për lejimin e pagesës shtesë për rrezikshmëri në punë për të punësuarit në Agjencinë Kundër Korrupsionit**

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e këtij komisioni, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

Udhëzohet Agjencia Kundër Korrupsionit që kërkesën për lejimin e rritjes së pagave për zyrtarët e saj t'ia adresojë Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave dhe Ministrisë së Shërbimeve Publike.

### **3.4 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Dragan Dimiq për realizimin e pagës në cilësinë deputetit të Kuvendit që nga data 21. 12. 2007**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

1. Ngarkohet sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, të konsultohet me Zyrën ligjore të UNMIK-ut lidhur me realizimin e kërkesës së deputetit Dragan Dimiq për kompensimin e pagës së deputetit dhe të përfitimeve të tjera, në mënyrë retroaktive për periudhën prej 21 12. 2007 deri më tani.
2. Kuvendi, në bazë të vendimit të PSSP-së, dt. 5 dhjetor 2008, për certifikimin e mandatit të deputetëve, ka paguar ish-deputetin Lubisha Zhiviq për periudhën e cekur në paragrafin 1 të këtij përfundimi. Kuvendi në vijën buxhetore për vitin 2008 ka parashikuar mjete financiare për pagat e 120 deputetëve, kurse tani me vendimin e PSSP-së, dt. 19 maj 2008, kërkohet t'iu paguhet paga dy deputetëve për një vend.

### **3.5 Shqyrtimi i kërkesës së kryetares së Komisionit për Integritet Evropian për lejimin e udhëtimit në Sarajevë, Bosnjë e Hercegovinë**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

Kërkesa e deputetes Zylfije Hundozi për lejimin e udhëtimit zyrtar në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë, nuk është në përputhje me Vendimin e Kryesisë nr. 02-2242-1/06, për lejimin e udhëtimeve jashtë vendit.

### **3.6 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri për lejimin e udhëtimit në Gjenevë, Zvicër**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri në Zvicër, për të marrë pjesë në Tryezën e rrumbullakët, me temën: “Mbikëqyrja parlamentare e sigurisë”, prej 1 deri më 5 qershor 2008.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për anëtarët e Komisionit i përballon organizatori i takimit, kurse mëditjet përballohen nga buxheti i Kuvendit.

### **3.7 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri për lejimin e udhëtimit në Shqipëri**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Komisionit Punë të Brendshme dhe Siguri për vizitë në Kuvendin e Shqipërisë, prej 16 deri më 19 qershor 2008, në përbërje: Zafir Berisha, Emrush Xhemajli, Agim Veliu dhe Gani Geci, deputetë të Kuvendit, Nur Çeku dhe Antigona Ibraj nga Administrata e Kuvendit.
2. Shpenzimet e qëndrimit për anëtarët e Komisionit i heq nikoqiri- organizatori i takimit, kurse mëditjet paguhen nga buxheti i Kuvendit.

### **3.8 Kërkesa e deputetit Mahir Jagcilar lidhur me formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Parlamentit të Kosovës dhe atij të Turqisë**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e deputetit Mahir Jagcilar, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

1. Kryesia e Kuvendi mbështet nismën e deputetit Mahir Jagcilar për formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Parlamentit të Kosovës dhe atij të Turqisë.

2. Ngarkohet Komisioni për Punë të jashtme i Kuvendit, në konsultim me grupet parlamentare, që të bëjnë propozimin e anëtarëve të këtij grupi, në bazë të performancës që kanë për këtë fushë.

### **3.9 Të ndryshme - dhurimi i kompjuterëve të përdorur**

**Kryesia**, me propozim të kryetarit të Kuvendit, mori këtë

#### **V E N D I M**

Kompjuterët (e përdorur) të Administratës së Kuvendit t'i dhurohen një apo dy shkollave me qëllim të ndihmesë së tyre në edukimin e gjeneratave të reja në fushën e teknologjisë informative.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12: 10 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

---

E hartoi:

**Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**